

AUDITORËT GJYQËSORË DHE PROKURORIAL, TË NEVOJSHËM PËR DREJTËSI TË REFORMUAR

Hydajet J. HYSENI*

Abstrakt:

Ky punim trajton në mënyrë analitike organizimin dhe funksionimin e sistemit të auditimit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë nën administrimin e përkohshëm të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Duke trajtuar rolin e këtij mekanizmi në vlerësimin e asaj se deri në çfarë mase janë arritur objektivat e sistemit të drejtësisë për t'u siguruar që të gjithë qytetarëve u ofrohet shërbim i paanshëm, i pavarur dhe transparent, e i bazuar në ligj, punimi kontribuon në debatin lidhur me administrimin sa më të mirë të sistemit të drejtësisë.

Fjalët kyçe: *Auditorët gjyqësorë e prokurorial, administrata e gjykatës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshillin Prokurorial i Kosovës.*

Në vend të hyrjes

Për të mos u trembur nga çfarëdo lloj kontrolli, do të duhej që paraprakisht të vetë-kontrollohemi. Për vetë-kontroll, nevojitet krijimi i mekanizmave të cilët do sinjalizojnë se jemi duke u gabuar apo mund të gabohemi nga ekzistimi i ndonjë rreziku të mundshëm. Pa dyshim që edhe administrata e drejtësisë do dëshironte që para çdo lloj kontrolli të del se është duke funksionuar më së miri, gjë që e dëshiron çdo dashamirës i shtetit. Andaj, organet e larta administruese të drejtësisë, gjithëherë duhet të jetë në dijeni se çfarë gjendje menaxhuese -të funksionimit të drejtësisë- ka në tërë territorin e republikës.

Administrimi i drejtësisë, për të kuptuar më mire se si po funksionojnë gjykatat dhe prokuroritë në brendësi të vetvetes dhe si po reflektojnë në marrëdhënie ndaj publikut, do t'i nevojitej që të funksionalizojë shërbimin e auditorëve. Misioni kryesor i këtyre auditorëve do ishte raportimi tek menaxhmenti i drejtësisë se deri në çfarë mase janë

* Për kohë të këtij shkrimi/Maj 2008, autori është jurist dhe punon në pozitën e Koordinatorit të Njësisë së Auditimit Gjyqësor të Kosovës, në Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut. Pikëpamjet e paraqitura këtu janë personale të autorit.

arritur objektivat e tyre për tu siguruar që të gjithë qytetarëve u ofrohet shërbim i paanshëm, i pavarur dhe transparent, e i bazuar në ligj.

Këta auditorë ushtrojnë si aktivitet të pavarur sigurimin objektiv dhe këshillëdhënës, për të ndërmarrë përmirësime të parapara që shtojnë vlera dhe përmirësojnë veprimet organizuese. Gjithashtu i ndihmojnë organizatës që të përmbushin objektivat e veta duke u bërë urëlidhje në qasje sistemore, disiplinore, që të vlerësojnë dhe përmirësojnë efektshmërinë e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe të proceseve qeverisëse.

Këta, për të funksionuar mirë, do të duhej që ta bënin shërbimin here të veçuar e here të kombinuar për menaxhmentin e gjyqësisë dhe të prokurorisë, por gjithherë duke e vrojtuar mirë vijën ndarëse dhe atë bashkëpunuese në mes të pushtetit gjyqësor dhe atij ekzekutiv.

1. Baza themeluese

Themelues i shërbimit të auditorëve gjyqësor dhe prokurorial për Kosovë do të ishte Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) në bashkërenditje me Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), ndërsa për Shqipëri Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) dhe Ministria e Drejtësisë (MD).

Në Kosovë, ky shërbim, zanafillën e themelimit e ka në Urdhëresën Administrative 2001/14, mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/15, për themelimin e Departamentin e Drejtësisë të datës 21 Mars 2000. Sipas kësaj Urdhërese përveç Divizioneve tjera ka funksionuar edhe Divizioni për Zhvillim Gjyqësor, në kuadër të të cilit ka vepruar Njësia e Inspektimit Gjyqësor (NJIGJ), me mandat për hetimin, verifikimin dhe auditimin e gjykatave dhe të prokurorive në Kosovë. Përkundër mandatit të gjerë për të hulumtuar dhe audituar, nga muaji Maj 2001 e deri në muajin Maj 2005, NJIGJ ka poseduar vetëm kapacitete që të hulumtojë rastet individuale të sjelljeve të pahijshme gjyqësore dhe prokuroriale. Duke ju falënderuar rritjes së buxhetit të vitit 2005, NJIGJ kishte lejuar që të angazhojë një personel të ngushtë të profesionistëve ligjor nga të cilët u përbë Sektorin e Auditimeve Gjyqësore (SAGJ) brenda NJIGJ-it. Prej 01.01.2006, SAGJ (tani quhet Njësia e Auditimit Gjyqësor) është plotësisht e kompletuar me personel, i cili është trajnuar dhe po funksionon mirë. Ky njësi është mirëpritur nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës. Gjithashtu, kjo njësi prej

themelimit është përkrahur dhe po përkrahet nga USAID/NCSC , të cilët funksionojnë në Kosovë.

Sikur krejtësisht të jenë të mëvetësishëm pushteti gjyqësor dhe ai ekzekutiv në të cilin bën pjesë prokuroria, atëherë do të duhej që menaxhmenti i gjyqësorit dhe ai i prokurorisë përmes një memorandumit, ligjërisht të mbështetur, të krijojnë autorizime të përbashkëta lidhur me aktivitetin e auditorëve gjyqësorë dhe prokurorial.

Në diskutime shpesh lind pyetja, përse këta auditorë duhet të auditojnë edhe gjyqësorin edhe prokuroritë-pse që të dy institucionet-kur ato nuk i takojnë të të njëjtit pushtet? Përgjigja mund të ishte se praktikisht është e pamundur që këtu të funksionojnë dy drejtori audituese, kur aktiviteti auditues gjykatë-prokurori është i lidhur ngushtë mes veti, sikur thuhet “mish e thua”.Për ta kuptuar edhe më mire këtë nevojë të përbashkësisë vepruese të auditorëve, të marrim shembullin e një teme audituese me titull “Rishikimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm për bashkëpunimin e gjykatave me prokuroritë”. Për këtë temë audituese, nëse auditorët do të ishin të veçuar-dy drejtori audituese- sipas institucioneve gjykatë-prokurori, në asnjë rast nuk do të ishte kryer auditimi sipas temës së dhënë në shembullin që përmendëm, me arsytim se do të mungonte kompetenca lëndore dhe do të ishte shumë vështirë që të sigurohej bashkëpunimi. Sikur ky auditim të bëhej nga dy drejtori audituese, do të mund të rezultonte fillimi i auditimit, por kurrë nuk do mbyllej sipas objektivit, dhe asnjëherë menaxhmenti (KGJK&KLD) nuk do furnizohej me informatë të saktë audituese, si dhe nuk do të kishte asnjë lloj rekomandimi të mirëfilltë se çka do të duhej ndërmarrë për të përmirësuar bashkëpunimin gjykatë-prokurori. Andaj, ky shërbim auditues duhet të funksionojë si një trup autonom, i cili drejtpërdrejtë do të punonte në varësi nga themeluesi i vet sikur do të ishte KGJK, KLD, KPK apo edhe MD.

2. Funksioni/mandati i auditorëve gjyqësor/prokurorial

Për Republikën e Kosovës, referuar Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2008/07 datë 14 Qershor 2008, për zbatimin e Rregullores nr. 2006/25 datë 27 prill 2006 mbi kornizën rregulluese për sistemin e drejtësisë në Kosovë, në nenin 4 përcakton funksionet e Njësisë së auditimit gjyqësor me këtë përmbajtje:

“4.1 NJAGJ-ja do të:

- a) Analizojë dhe vlerësojë funksionimin e gjykatave dhe prokurorive publike;

- b) Analizojë dhe vlerësojë aktivitetet specifike gjyqësore ose të prokurorisë me qëllim të propozimit të reformave të reja për aktivitetet e tilla;
- 4.2 NJAGJ-ja ua paraqet raportet përfundimtare për përfundimet dhe rekomandimet e saj Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ministrisë së Drejtësisë, Kuvendit të Kosovës dhe Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut.”

Atëherë, bazuar në këto dispozita, del se funksioni dhe qëllimi i auditimit gjithëherë do të ishte përpjekje për përmirësimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Ky qëllim do të orientohet për të parë se a po gjen zbatim sundimi i ligjit, a po mbrohen të drejtat e palëve nga gjykatat dhe nga prokuroritë, do të identifikonte praktikat më të mira të cilat do të aplikoheshin në ndonjë gjykatë apo prokurori dhe do të kuptonte pengesat që paraqiten tek gjykatësit dhe prokurorët gjatë ushtrimit të detyrës, dhe krejt në fund analizon të kuptuarit mbi zbrazëtitat e ligjit të cilat do të kishin penguar ndonjë proces për reformim.

Auditimi gjyqësor/prokurorial duket sikur është mekanizëm preventiv permanent kundër korrupsionit në sistemin e drejtësisë. Ky mekanizëm është i padukshëm sepse asnjëherë nuk ka kompetencë represive, por me anë të reformës ndikon futjen në përdorim të mekanizmave të brendshëm të kontrollit të cilët do të ndikonin direkt në parandalimin e çdo lloj aktiviteti që çon kah korrupsioni.

Komuniteti gjyqësor/prokurorial do duhej takuar në konferenca punuese për ta kuptuar qartë dallimin bashkëkohorë të auditorëve nga inspektorët gjyqësor/prokurorial. Pra, duhet kuptuar se auditori rishikon funksionimin e tërësishëm të sistemit gjyqësor/prokurorial, me detyrë që përmes rekomandimeve të raportit, të jep ide për funksionim më të mirë, ndërsa inspektori heton rastin individual lidhur me ndonjë mospajtueshmëri të veprimtarisë gjyqësore/prokuroriale, me detyrë që ndaj personit të caktuar të iniciojë procedurë adekuate.

Për ekzistimin dhe funksionimin e këtij shërbimi, ndoshta Kosova ishte më me “fat”, ngase për nga misioni që ka NJAGJ-i, duket se janë të parët për nga koha e themelimit, karshi shteteve tjera. Mendojmë se menaxhmentët e drejtësisë së çdo shteti do ndaheshin shumë të kënaqur po të përdornin auditimin gjyqësor/prokurorial, sikurse e ka Kosova.

Procedurat dhe metodologjitë me të cilat punon NJAGJ, janë sipas standardeve ndërkombëtare për praktikë profesionale të auditimeve të brendshme (IAB), (botimi i fundit, janar 2004) por i përshtatur dhe në pajtim me nevojat e sektorit të drejtësisë së Kosovës.

Për të siguruar që metodologjia dhe procedurat mbesin në pajtim me praktikat më të mira dhe se ato pasqyrojnë mjedisin ligjor, NJAGJ është përgjegjës për shqyrtimin aty ku është e domosdoshme, amendimin e përmbajtjeve, metodologjinë dhe procedimin. Ky shqyrtim bëhet për çdo vit ose edhe më shpesh, nëse është e nevojshme.

Gjatë kryerjes së rolit të vet, auditimi gjyqësor/prokurorial vepron si shërbim i KGJK, KPK, KLD dhe i menaxhmentit të tyre përkatës, duke matur dhe vlerësuar efektivitetin e sistemeve vepruese të sektorit të drejtësisë, duke siguruar dhe këshilluar mbi kontrollet e brendshme të përcaktuara dhe për të siguruar që:

- Praktikrat e kontrollit janë në pajtim me ligjet, mënyrat vepruese (politikrat) dhe procedurat;
- Pasuritë dhe interesat e sektorit të drejtësisë janë të mbrojtura në mënyrë të përshtatshme nga çfarëdo humbje ose dëmtim;
- Objektivat janë të njohura dhe do të arrihen me një çmim të duhur, përfshirë cilësi dhe shërbim të mirë për qytetarë;
- Bëhet kompletimi dhe besueshmëria e të gjitha të dhënave të sektorit të drejtësisë të gjykuara për qëllime vendimmarrëse;
- Bëhet përdorimi ekonomik dhe efikas i burimeve.

Në fund, i furnizon ata me analiza, vlerësime, rekomandime, këshilla dhe informata në lidhje me aktivitetet e shqyrtuara. Objektivi përfshin promovimin e kontrollit efektiv me kualitete të larta profesionale të të punësuarve, shpenzim kohe dhe paraje të arsyeshme.

3. Përbërja e shërbimit të auditorëve gjyqësor/prokurorial

Pasi që i tërë aktiviteti i gjykatësve dhe i prokurorëve, është i lidhur ngushtë me administrimin gjyqësor respektivisht prokurorial, do të ishte më se e nevojshme që auditorët të jenë juristë të dalluar me njohuri për administrim dhe menaxhim gjyqësor respektivisht prokurorial. Këta auditorë do të ishte e nevojshme që së paku të kenë

përgatitje shkollore dhe profesionale sikurse për një prokuror ose gjykatës fillestar të nivelit (apo shkallës) së parë.

Po të jetë e mundur, do të ishte e nevojshme që këta auditor paraprakisht të kenë njohuri të shkëlqyera të proceseve të përgjithshme gjyqësore/prokuroriale duke filluar prej paraqitjes së parashtrësës në gjykatë/prokurori duke kaluar kështu nëpër të gjitha stadet vendosëse/procedurale deri në momentin e arkivimit të lëndës.

Do të ishte me shumë dobi, që këta auditor përveç që të jenë njohës të shkëlqyer të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, të jenë entuziastë dhe njohës të proceseve reformuese. Gjithashtu të jenë përmbushës të tri kërkesave themelore për reformimin e sistemit të drejtësisë:

- Shpejtësi më e madhe në punë;
- Më me pak shpenzime buxhetore dhe
- Transparencë e plotë dhe ligjore mbi aktivitetin gjyqësor/prokurorial.

Për tu ushtruar ky funksion, auditori gjyqësor/prokurorial, asnjëherë nuk mund t'i përbush detyrat e veta nëse do jetë mbrojtës i sistemeve tradicionale në drejtësi. Për të mos ndodhur kjo, do të ishte detyrë paraprake që organet e drejtësisë, të posedojnë një listë emrash me juristë të cilët shprehin dhe kanë shprehur vetiniciativa për ndryshime progresive- bashkëkohore, se janë pjesë e juristëve reformatorë.

Nuk do të ishte shumë bindëse të na dukej një jurist reformator nëse ai do të ishte vetëm njohës i mirë i ligjeve në njërën anë, ndërsa në anën tjetër të mos ishte prirës i identifikimeve të nevojave për drejtësinë aktuale/reformatore. Po të mjaftonte vetëm të njohurit e ligjit për të qenë element reformator i drejtësisë, atëherë do del se këtë pjesë të punës ndoshta mund ta bëjë edhe ndonjë ish deputet i kuvendeve. Andaj, këtë punë do ta bënin vetëm juristët e dhënë pas reformave. E fundit “zanati” i reformatorit jurist nuk merret vetëm me një të caktuar në një grup punues reformator, por kërkon njohje, analizë, sintezë dhe vlerësim të të provuarit e reformës se si do të dukej-funksiononte. Këta reformatorë juristë apo rishikues të sistemit të drejtësisë të cilët me një emërues do të quheshin auditorë gjyqësor/prokurorial, kanë për detyrë që ta bindin menaxhmentin e vet se pjesa e reformës i plotëson kushtet për tu futur në zbatim, e më pas, të angazhohen për të parë a po ndodh një zbatim i tillë. Nëse po, duhet shikuar a po

funksionon mire. Nëse eventualisht nuk funksionon mire, menaxhmentin duhet njoftuar dhe propozuar se çka duhet ndërmarr për t'i evituar pengesat.

Thënë më ndryshe, auditorët nuk janë pjesë e punës vetëm për ndonjë periudhë të caktuar kohore, derisa të realizohet ndonjë pjesë e reformës në drejtësi. Këta duhet punuar pandërprerë, në mënyrë që menaxhmenti të jetë i kënaqur që para apo pas ndryshimit të ligjeve të drejtësisë, nga auditorët të paralajmërohet se çka duhet ndërmarr më tej për përmirësimin e sistemit. Së fundi auditorët gjyqësor/prokurorial janë “nuhatësit” e parë të cilët identifikojnë se duhet reformuar sistemi i drejtësisë në baza ligjore apo institucionale, koncepte që menaxhmentit shpesh i ngatërrohen.

4. Punëmarrja

Çdo aktivitet i auditorëve do të jetë në vartësi të kërkesave audituese të dhëna nga KGJK ose KPK respektivisht nga KLD. Kërkesat e këtyre menaxhmentëve, qofshin për gjyqësor apo për prokurori do të jenë të paraprirë në planin strategjik të auditimit, por gjithëherë me mundësi për ndonjë temë të re kur KGJK/KPK respektivisht KLD/MD konsiderojnë se është nevojë me prioritet.

Të gjithë të punësuarit që punojnë në vartësi të të njëjtit punëdhënës të gjyqësisë dhe prokurorisë do të detyroheshin për të bashkëpunuar me auditorët gjyqësor/prokurorial. Kështu në Kosovë sipas nenit 5 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut nr. 2008/7, thuhet “Anëtarët e ... NJAGJ-së, gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare, do të kenë autorizimet e përgjithshme për..., verifikim dhe vlerësim, duke përfshirë edhe qasjen e papenguar dhe mundësinë për të marrë çdo dokument të dobishëm ose dokument gjyqësor, si dhe të drejtën për të marrë në pyetje çdo person që punon në sistemin gjyqësor ose çdo person tjetër që mund të jep informacione të rëndësishme në lidhje me qëllimin e ... auditimit”.

Për të zhvilluar me sukses auditimin gjyqësor/prokurorial, për punëmarrje do të nevojiten së paku 2 ose 3 ekipe nga tre auditorë, 1 koordinatör (apo drejtor), 1 administrator dhe 1 asistent administrate, duke iu ndarë linjë të veçantë buxhetore. Këtu duhet patur kujdes që ky staf të mos e zhvillojë as të vetmin aktivitet në terrenet gjyqësore/prokuroriale derisa nuk trajnohet mire dhe autonom me specifika për gjyqësi/prokurori.

Sistemi i kontrolleve të brendshme do të jetë sistem i përshkruar i drejtësisë dhe i proceseve, rregullave dhe procedurave të tjera punuese përfshirë strukturat organizuese, metodat dhe proceset e caktuara nga kryetarët e gjykatave dhe shefave të prokurorive publike, brenda përfshirjes së punës së tyre në mënyrë që të sigurohen që veprimet e përgjithshme të auditimit (auditorëve) të kryhen në mënyrë ligjore, ekonomike, efikase dhe efektive.

5. Llogaridhënia

Llogaridhënia është njëra nga parimet më të rëndësishme që nënvizon punën e kryetarit të gjykatës ose të shefit të prokurorisë, si dhe punën e secilit menaxhues. Kjo do të thotë të qenit përgjegjës ndaj dikujt, për arritjen e objektivave të punës, si shtesë duhet kërkuar ekzistimin e një mekanizmi i cili do të identifikonte nevojat për përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

Andaj, auditorët gjyqësor/prokurorial do të ishin llogaridhënës direk tek KGJK/KPK respektivisht KLD/MD. Raportet e auditorëve nuk do duhej të kalojnë nëpër dyert e zyrtarëve të cilët mund të ishin të audituar. Këta auditorë, sikur të ishin llogaridhënës tek zyrtarët e ndryshëm, rrezikojnë që të mos e kryejnë misionin për të cilin janë themeluar, ndoshta, edhe pa dashje të auditorëve, do të politizohej ky shërbim.

Për tu siguruar KGJK/KPK, respektivisht KLD/MD, lidhur me njohjen e gjendjes në gjyqësor, respektivisht në prokurori, duhet që këta të jenë të informuarit e parë me raportet e auditimit. KGJK, respektivisht KLD, do të ishin të vetmit kompetent ekskluziv për të shpërndarë informacionin apo të gjeturat nga auditimi, edhe pse tani në Republikën e Kosovës përveç KGJK, raporti i dorëzohet edhe Ministrisë të Drejtësisë, Kuvendit të Kosovës dhe Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut.

Njësia e Auditimeve Gjyqësore/Prokuroriale, përveç që çdo raport me të gjetura dhe rekomandime do duhej dorëzuar punëdhënësit të vet, së paku një here në vit, duhet raportuar mbi aktivitetin e përgjithshëm punues. Kështu në Kosovë, Urdhërsa Administrative e UNMIK-ut, nr. 2008/7, neni 4.3 urdhëron që “NJAGJ-ja paraqet një raport vjetor për auditimet e kryera dhe për hapat e ndërmarrë nga organet përkatëse për adresimin e konstatimeve të auditimit Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Ministrisë së

Drejtësisë, Kuvendit të Kosovës dhe Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut.” Detyra e përgjithshme llogaridhëse e auditorëve gjyqësor/prokurorial është që të ndërmerr, në emër të menaxhmentit të sektorit më të lartë të drejtësisë (KGJK & KPK&KLD), ekzaminim të pavarur të strukturave që drejtojnë punët dhe të bën ruajtjen e sigurt dhe menaxhimin e përshtatshëm të sektorit të drejtësisë për të cilin, se fundi, ata kanë përgjegjësi. Rekomandimet e auditimit do duhej të synojnë vlerën maksimale për mjetet e përdorura për të cilat menaxhuesit e sektorit të drejtësisë do ishin llogaridhëës ndaj tatimpaguesve.

6. Rëndësia

Auditimi gjyqësor/prokurorial do të ndihmojë sektorin e drejtësisë në përmbushjen e objektivave e veta të përkufizuara duke inkurajuar dhe duke u bërë urë lidhëse sistemore, duke pasur qasje të disiplinuar në punë, në mënyrë që të jep rekomandime për të përmirësuar efikasitetin e menaxhimit të rrezikut, kontrollit të brendshëm dhe duke u kujdesur për një proces qeverisës llogaridhëës.

Auditimi gjyqësor/prokurorial duhet të ketë objektiv të pavarur dhe aktivitet këshillëdhënës të përcaktuar që të shtoj vlerën dhe të përmirësoj veprimet e punës së gjykatave dhe të prokurorive nën kontrollimin e KGJK/KPK/KLD dhe MD.

Auditimi gjyqësor, respektivisht prokurorial, për shtetet e regjionit do të ishte risi funksionale në njërin anë, ndërsa në anën tjetër do të qonte kah rruga e sigurt e reformimit. Krijon kujdestar institucional të cilët në çdo kohë e raportojnë punëdhënësin, se çka duhet ndërmarrë për tu përmirësuar sistemi i punës së gjykatave dhe i prokurorive. Është indikatorë për rritjen e besimit të publikut për gjykatat dhe për prokuroritë. Do të ishte bartës i ideve se cilat fusha të drejtësisë janë më me prioritet të nevojshme për reformim/ndryshim. Aktivitet, ky, i cili auditorët në mënyrë permanente do t'i përcillte gjatë gjithë punës. E fundit, aktiviteti i auditorëve gjyqësor/prokurorial do të arsyetohej me posedimin e aftësive shumë të larta lidhur me reformimin e përgjithshëm të sistemit të drejtësisë në shtet.

Për menaxhmentin e drejtësisë, auditorët, do ishin siç thuhet “krah i djathtë” i tyre. Thënë më ndryshe, auditorët, për menaxhmentin gjyqësor/prokurorial, janë të vetmit

raportues që në mënyrë shumë analitike nxjerrin në sipërfaqe pengesat të cilat kërkojnë evitim/zgjidhje.

Për auditorët gjyqësor/prokurorial, do të ishte nëpërkëmbje që të merren me raportime të cilat raportohen edhe në rrugët tjera. Nuk do ishte shumë e rëndësishme për këta auditorë që të auditojnë p.sh. shpenzimin e buxhetit, sepse këtë e bëjnë edhe shumë mekanizma tjerë të shtetit. Por, do të ishte shumë e pranuar që të auditohen proceset për të cilat fare nuk kanë ide kompetentët (ngase nuk ka kush i raporton, ndërsa menaxherët e terrenit nuk detyrohen të merren me këtë aktivitet) se nga procesimi (p.sh) i tanishëm i gjyqësorit/prokurorisë, shumë milionë Euro mbesin pa u inkasuar në buxhetin e shtetit, ose (p.sh.) zvarritja në vendosje dhe procedim të mëtejshëm të një çështjeje gjyqësore/prokuroriale. Atëherë për të bërë kesi identifikimi duhet ekzistuar një trup gjyqësor/prokurorial, e këta do të ishin auditorët gjyqësor dhe prokurorial.

Auditorët identifikojnë mundësitë për ndryshime të proceseve gjyqësore/prokuroriale, pa e dëmtuar kornizën ligjore, me efikasitet dhe me shpenzime më të vogla buxhetore për t'i kënaqur punonjësit dhe të gjithë qytetarët. Identifikon pengesat ligjore që do duhej eliminuar/ndryshuar, në mënyrë që do të lejonin futjen mekanizmave të ri për kontroll të brendshëm në gjykatë/prokurori.

Auditorët, menaxhmentit të vet, i japin guximin që para dy pushteteve tjera (legjislativit dhe ekzekutivit), të prezantojë një çështje reale mbi gjendjen e funksionimit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial. Me kohë do të jenë të informuar edhe për nevojat shtesë buxhetore të cilat në vetvete reflekton tek hapja e rrugës për reformim. Gjithashtu të vetmit dhe më kompetentët do të ishin auditorët të cilët do të identifikonin masën e shumës së parasë e cila nuk ishte inkasuar në buxhetin e shtetit. Këtë mosinkasim eventual, auditorët financiar-ekonomist e kanë shumë të vështirë për ta identifikuar, ngase paratë janë të deklaruara në vendime gjyqësore, për të cilat kërkohet për të kuptuar fillimin e momentit të fuqizimit të vendimit. Thjeshtë, është qasje për shumë here më e lehtë për auditorët juristë se sa për auditorët ekonomistë.

E rëndësishme në punë të auditorit është se auditori asnjëherë për rezultate të punës nuk do duhej veprorë duke u shprehur sipas vetës së pare njëjës me “unë”, por do të vepronte duke u shprehur sipas vetës e pare shumës me “ne”, shprehje e cila na bën për të kuptuar se auditorët e bëjnë punën në grup. Do të ishte kështu, sepse kur flitet për

përmirësimin e sistemit të drejtësisë, ku për mosfunksionim apo funksionim të mirë të sistemit të drejtësisë, bashkërisht që të gjithë të punësuarit në sistemin e drejtësisë jemi përgjegjës, madje edhe të gjithë taksapaguesit. Ndërsa përdorimi i shprehjeve sipas vetave “ti” dhe “ju”, për sistem të drejtësisë duket se është i rezervuar vetëm për inspektorët gjyqësor/prokurorial me faktin se këta procedojnë raste individuale. Ky shpjegim u paraqit kështu, me qëllim që të mirëkuptohet se në sistemin gjyqësor/prokurorial, auditorët asnjëherë nuk mund të inspektojnë, por as inspektorët nuk mund të auditojnë. Më shkurt, auditori nuk është inspektor e as inspektori nuk është auditor.

Për përfundim të kësaj pike referuese, është përshkruar një pjesë të deklaratës së misionit të Njësisë së Auditimit Gjyqësor të Kosovës, ku ndër të tjera thuhet: “Njësia e Auditimit Gjyqësor (NJAGJ), përmes procesit të auditimit të brendshëm, synon që, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), gjykatat dhe prokuroritë nën kontrollimin e tyre, të siguroj shqyrtimin profesional të cilësisë së lartë dhe efikas, sigurimin dhe këshillimin për të përmirësuar shërbimin, brenda burimeve të mundshme.

Cilësia e kryerjes së punës së auditimit të brendshëm nëpër institucionet e brendshme plotësisht varet nga zbatimi i rregullave dhe i metodave ... si profesionist të auditimit të brendshëm. Profesionalizmi varet dukshëm nga objektivi i vështrimeve dhe i mendimeve. Cilësia e mendimit ... përpunohet në zbatimin e standardeve të auditimit dhe në ndikimin ... e rekomandimeve...

Si auditor i brendshëm, NJAGJ nuk luan rolin e inspektimit në sektorin e drejtësisë. Më parë, NJAGJ ka nevojë për bashkëpunimin e personelit dhe të menaxhuesve në mënyrë që të merr informata të mirëfillta dhe të mjaftueshme që të vazhdojë dhe kryej detyrat e veta. Mënyra më e mirë për të nxitur atmosferë të besimit dhe të bashkëpunimit të ndërsjellë është që auditorët e NJAGJ-it të miratojnë një qasje pjesëmarrëse, të jenë transparent në detyrën dhe në objektivin e tyre dhe të mbajnë marrëdhënie profesionale gjatë tërë kohës. Së fundi, reputacioni dhe respekti do të varet nga këto dy cilësi...”

Në vend të përfundimit, themi se po bëhet përpjekje që të reformohen sistemet e drejtësisë duke i shfrytëzuar përvojat e shteteve që kanë filluar më herët dhe ende po vazhdojnë me reformimin e sistemeve të tyre të drejtësisë. Gjithashtu do duhej të

mirëshfrytëzoheshin kuadrot tona të cilat kanë mundësi dhe vullnet për bashkëpunim me profesionistët vendor dhe ndërkombëtar. Lidhur me këtë shërbim, së bashku të shpresojmë se nuk do të na mungojë përkrahja nga institucionalistët kompetent shtetëror dhe as nga ata ndërkombëtar.

7. Për një të ardhme jo të largët

Ndoshta për të ardhmen jo të largët, do duhej menduar, që në kuadër të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, të funksionojë Departamenti i auditimit për gjyqësi/prokurori, i cili atëherë mund të quhej Departamenti i auditimit të drejtësisë, krahas dy departamenteve të tjera sikur do të ishin Departamenti i auditimit të ekzekutivit dhe Departamenti i auditimit të legjislativit. Këtu, secili departament do të kishte nga një drejtor, ndërsa në krye të të tri departamenteve do të ishte një drejtor i përgjithshëm, i cili do t'i përgjigjej kuvendit të shtetit.

Ky organizim do të dukej më i mirë për dy arsye: E para; krijon një kornizë organizative dhe autonome sikurse tri pushtetet shtetërore, por të lidhura në një pike.

E dyta; sipas departamenteve të auditimit të zyrës së përgjithshme të auditorit, do të bëhej ndërlidhje kontrolluese dhe raportuese me njësitë apo sektorët e auditimeve të brendshme të secilit institucion veç e veç sipas linjës ndarëse të pushtetit shtetëror.

Për të sqaruar se çka do mund të bëhej me tepër se sa sot- ky departament i auditimit të drejtësisë-do të funksiononte ndaj çdo shërbimi të drejtësisë së shtetit. Te ky departament do të ishin llogaridhënës të gjitha njësitë apo sektorët e auditimit të brendshëm të drejtësisë sikurse gjyqësori, prokuroria, burgjet dhe administrata e përgjithshme e ministrisë së drejtësisë, duke shtuar se këto dy të fundit do duhej që këto marrëdhënie në mënyrë të tërthortë t'i kenë edhe me Departamentin e auditimit të ekzekutivit.

Ky organizim do të tregonte një zinxhir pozitiv me përpjekje kah mbajtja e hapit për reformim të sistemit të drejtësisë, në njërën anë, ndërsa në anën tjetër, vjen në shprehje transparenca e plotë ndaj institucioneve dhe taksapaguesve në përgjithësi, duke reflektuar dhe bindur publikun se është duke sunduar ligji. Po të bëhej kështu në një të ardhme, menaxhmenti qendror i drejtësisë për shumë here më lehtë dhe më saktë, do të

ishte përfaqësues më i besuar dhe më i fuqishëm karshi pikave tjera të pushtetit shtetëror dhe politik.

Nuk do të ishte e tepërt për drejtësinë, që përmes Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm apo zyrës së Kontrollit të Lartë të Shtetit, të gjitha institucionet relevante të shtetit të jenë të njoftuara me aktivitetin e organeve të drejtësisë. Këtë do ta dëshirojë taksapaguesi. dhe opinionin ndërkombëtar.

8. Konkluzionet

Auditorët gjyqësor/prokurorial:

- Janë të nevojshëm për sistemin e drejtësisë;
- Janë të dëshirueshëm për publikun vendor dhe ndërkombëtar;
- Nuk inspektojnë gjykatësit/prokurorët dhe sekretarinë e tyre, por auditojnë punën e gjykatësve/prokurorëve dhe sekretarive të tyre, si tërësi funksionale të sistemit;
- Nuk paragjykojnë dhe kritikojnë, por udhëzojnë dhe këshillojnë;
- Janë jurist të dalluar për reforma në drejtësi;
- Janë identifikues permanent të nevojave për reformim të sistemit të drejtësisë;
- Themelohen nga organet më të larta të gjyqësisë/prokurorisë;
- Për aktivitetin punues, bëjnë llogaridhënie tek themeluesi dhe
- Raportet me të gjetura dhe rekomandime, përveç themeluesit ia dorëzojnë edhe dy pushteteve tjera shtetërore.

Bibliografi

I. Burimet nga kuadri rregullues i Republikës së Kosovës

1. Rregulloret e UNMIK-ut:

- 2000/15, mbi themelimin e Departamentit të Drejtësisë;
- 2002/18, mbi themelimin e Zyrës së revizorit të përgjithshëm dhe zyrës së revizorit të Kosovës;
- 2006/25, mbi kornizën rregulluese për sistemin e drejtësisë në Kosovë;
- 2007/17, mbi zbatimin e Ligjit për auditimin e brendshëm.

2. Urdhëresat administrative të UNMIK-ut:

- 2001/14, mbi zbatimin e Rregullores 2000/15;
- 2008/07, mbi zbatimin e Rregullores 2006/25.

3. Ligjet:

- Ligji mbi gjykatat e rregullta “Gazeta Zyrtare” e KSAK, me tekst të spastruar nr. 21/78, 49/79, 44/84 dhe 18/87;
- 02/L-74, mbi auditimin e brendshëm;
- 03/L-75, mbi Zyrën e auditorit të përgjithshëm dhe Zyrën së auditimit të Kosovës.

4. Akte nënligjore:

- Rregulla mbi veprimtarinë e brendshme të gjykatave, “Gazeta Zyrtare” e KSAK, nr. 7/81.

5. Materiale nga Njësia e Auditimit Gjyqësor:

- Nga konferenca e 72 pjesëmarrësve të kryetarëve të gjykatave dhe të kryeprokurorëve të prokurorive publike, datë 5 Prill 2006, për promovimin e Sektorit të Auditimit Gjyqësor;
- Doracaku i NJAGJ-it;
- Plani strategjik i NJAGJ-it;
- Trajnimet për auditor gjyqësor;
- Trajnimet për auditor të brendshëm;
- Trajnimet për trajner të auditorëve gjyqësor;
- 250 intervista me Kryetar gjykatash, me Kryeprokurorë dhe me Administratorë;
- 17 raporte të auditimit të NJAGJ-it;

- Human Dynamics – Projekt për përkrahje të mëtutjeshme të kontrollit të brendshëm të financave publike – financuar nga Bashkësia Evropiane dhe i menaxhuar nga Agjencioni Evropian për Rindërtim.

II. Burimet nga kuadri rregullues i Republikës së Shqipërisë

1. Miratuar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, nr. 345, datë 1.6.2004:

- Manuali i procedurave të auditimit të brendshëm në sektorin publik;
- Kodi i etikës për auditorët e brendshëm në sektorin publik;
- Karta e auditimit të brendshëm publik.

2. Projekt strategjia për zhvillimin e KLSH, 2005-2008.